



Amiso

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLOR

RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN

4/MUJORI I DYTË I VITIT 2025

1. Baza ligjore

Ky raport është hartuar në zbatim të kuadrit normativ në fuqi, konkretisht:

- **Ligji nr. 68/2017**, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor”;
- **Ligji nr. 139/2015**, i ndryshuar, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- **Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008**, i ndryshuar, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- **Ligji nr. 115/2024, datë 03.12.2024**, “Për Buxhetin e vitit 2025”;
- **Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018**, i ndryshuar, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”;
- **Vendimi i Këshillit të Qarkut Vlorë nr. 25, datë 24.12.2024**, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”.

2. Qëllimi i raportit

Raporti paraqet rezultatet e monitorimit të zbatimit të buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë për tremujorin e dytë 2025, duke vlerësuar:

- realizimin e të ardhurave nga burimet vetjake dhe transfertat;
- ecurinë e shpenzimeve sipas programeve dhe zërave ekonomikë;
- ndikimin e menaxhimit financiar në cilësinë e shërbimeve të ofruara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLOR

3. Misioni i Këshillit të Qarkut Vlorë

Këshilli i Qarkut Vlorë:

1. Harton dhe zbaton politika rajonale, të harmonizuara me politikat kombëtare, në përmbushje të funksioneve të përcaktuara me ligj;
2. Koordinon dhe lehtëson bashkëpunimin ndërmjet nivelit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore të rajonit;
3. Krijon partneritete me aktorë lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë, duke synuar zhvillimin socio-ekonomik të qëndrueshëm dhe përmirësimin e shërbimeve për komunitetin;
4. Merr pjesë aktive në programe ndërkufitare dhe iniciativa të financuara nga BE-ja, me fokus rritjen e kapaciteteve institucionale dhe të ekonomisë vendore.

4. Objektivat kryesore për vitin 2025

- Harmonizimi i politikave rajonale me prioritetet kombëtare të zhvillimit;
- Hartimi i Planit Sektorial për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik në territorin e qarkut;
- Zgjerimi i pjesëmarrjes në programe ndërkufitare dhe ndërrajonale për zhvillim të qëndrueshëm;
- Nxitja e bashkëpunimit midis njësive të qeverisjes vendore në rajon;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve publike dhe forcimi i qeverisjes së mirë;
- Rritja e kontributit të qarkut në procesin e integritetit evropian.

5. Burimet e financimit gjatë tremujorit II 2025

1. Të ardhurat vetjake (tarifa dhe shërbime të miratuara me vendime të Këshillit të Qarkut);
2. Transferta e pakushtëzuar (granti);



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLOR

3. Transferta të kushtëzuara (fonde specifike projektsh).

6. Realizimi i të ardhurave

- Të ardhurat vetjake janë planifikuar në bazë të metodës dinamike, duke u mbështetur në tendencat historike të arkëtimeve dhe realizimin faktik të vitit 2024.
- Është siguruar një balancë e qëndrueshme midis të ardhurave të arkëtuara dhe nevojave për financimin e programeve prioritare.

7. Realizimi i shpenzimeve


- Shpenzimet janë menaxhuar në përputhje me planin vjetor, duke garantuar financimin e aktiviteteve dhe projekteve të miratuara;
- Janë respektuar kufijtë buxhetorë dhe procedurat e prokurimit, duke siguruar efikasitet dhe transparencë.

Të ardhurat në buxhetin e Këshilit të Qarkut për këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:

Te ardhurat	Plani 2025 4/mujor	Fakti 2025 4/mujor	Realizimi ne %	Diferenca ne leke
1. Transferta e pakushtëzuar	35,453,429	20,393,336	58	15,060,093
2. Te ardhurat e veta	10,400,000	289,400	2.8	10,110,600
a. Te ardhura nga tarifat	400,000	289,400	72	110,600
b. Te ardhurat nga kuota e antaresise	10,000,000	0	0	10,000,000
3. Te ardhura te trasheguara (Grant+te ardhura)	37,218,680	9,958,500	27	27,260,180
4. Transferta e kushtëzuar	22,055,578	9,608,275	43	12,447,303
a. DAMT	4,400,000	3,022,432	69	1,377,568
b. Qendra Psiko Sociale Vatra	17,655,578	6,585,843	37	11,069,735
TOTAL	105,127,687	40,249,511	39	64,878,176



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLOR



Analiza e realizimit të të ardhurave për 4-mujorin e parë të vitit 2025

Për periudhën **janar–prill 2025**, të ardhurat totale të realizuara në buxhetin e Këshillit të Qarkut Vlorë janë në shumën **40,249,511 lekë**, që përfaqëson **39% të planit vjetor**. Të ardhurat janë të strukturuar si më poshtë:

1. Transferta e pakushtëzuar (Granti i pakushtëzuar)

Gjatë 4-mujorit të parë është realizuar në shumën **35,453,429 lekë**, që përbën **58% të planit të kësaj kategorie**.

Kjo transfertë vazhdon të mbetet **burimi kryesor i financimit të funksioneve të veta** të Këshillit të Qarkut, duke mundësuar përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me ligj. Celja e saj është bërë në përputhje me **planifikimin fillestar të buxhetit të ndarë në tremujorë**, ndërkohë që **nuk ka pasur asnjë ndryshim në vlerën e saj** gjatë kësaj periudhe.

2. Të ardhurat vetjake të institucionit

Të ardhurat vetanake të arkëtuara gjatë kësaj periudhe janë **289,400 lekë**, ose **2.8% e planit vjetor**, duke krijuar një **diferencë prej 10,110,600 lekësh** nga plani fillestar.

Vlen të theksohet se **planifikimi i këtyre të ardhurave bazohet në trendin e realizimeve të viteve të mëparshme**.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLOR

Për shkak të natyrës së paqëndrueshme dhe të vështirë për t'u parashikuar të disa burimeve, si **tarifat nga DAMT, urbanistika etj.**, ka pasur devijime në realizimin faktik.

3. Të ardhurat nga kontributet e bashkive

Për këtë periudhë nuk është realizuar asnjë derdhje nga bashkitë e Qarkut në formën e kuotës së anëtarësisë.

Megjithatë, **bazuar në përvojën e viteve të kaluara**, pagesa e këtyre kontributeve zakonisht fillon në **4-mujorin e dytë të vitit**, prandaj pritshmëritë janë që derdhjet të ndodhin në muajt në vijim.

4. Të ardhurat e mbartura nga viti 2024

Totali i fondeve të trashëguara nga viti 2024, përfshirë grantin dhe të ardhurat e mbartura, është **37,218,680 lekë**.

Këto të ardhura janë **planifikuar të përdoren në përputhje me vendimet e Këshillit të Qarkut**, si pjesë e buxhetit të vitit 2025.

Përdorimi i të ardhurave të realizuara

Të ardhurat e realizuara gjatë 4-mujorit të parë janë përdorur për financimin e funksioneve të veta, sipas destinacioneve të miratuara:

- **Paga për personelin administrativ dhe funksionarët e zgjedhur/emëruar;**
- **Kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore të personelit;**
- **Shpenzime operative për funksionimin e institucionit;**
- **Investime në infrastrukturë**, të realizuara në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me **propozimet e ardhura nga bashkitë dhe të miratuara nga Këshilli i Qarkut**.

Të ardhurat nga fondet e kushtëzuara për vitin 2025

Gjatë periudhës së 4-mujorit të parë të vitit 2025, Këshilli i Qarkut Vlorë ka përfutur fonde nga transfertat e kushtëzuara të buxhetit të shtetit, në shumën totale prej 22,055,578 lekë. Këto fonde janë ndarë si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLOR

- 4,400,000 lekë si transfertë e kushtëzuar për mbulimin e funksionit të deleguar që lidhet me veprimtarinë e Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark.
- 17,655,578 lekë si fond social për Qendrën Psiko-Sociale “Vatra”, akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me destinacion mbulimin e shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe ushqim.

Gjatë kësaj periudhe nuk janë kryer asnjë ndryshim në vlerën ose strukturën e transfertave të kushtëzuara, të cilat janë përdorur në përputhje me destinacionin dhe funksionet e miratuara sipas legjislacionit në fuqi.

Analiza e realizimit të shpenzimeve për periudhën janar–prill 2025

Gjatë periudhës **4-mujore të parë të vitit 2025**, shpenzimet e buxhetit të Këshillit të Qarkut Vlorë janë realizuar në shumën **40,249,511 lekë**, nga një total i planifikuar prej **105,127,687 lekë**, duke përbërë kështu **39% të planit vjetor**.

1. Shpenzimet korrente

Nga totali i realizuar, **shpenzimet korrente** përbëjnë shumën **20,393,336 lekë**, që korrespondon me **36% të planit** përkatës për këtë zë (planifikimi vjetor: 56,647,605 lekë). Kjo realizohet kryesisht në kuadër të **Programit 01110 – Administrimi i Këshillit të Qarkut**.

Mosrealizimi i plotë i shpenzimeve në këtë kategori lidhet me:

- **Mosrealizimin e disa zërave të shpenzimeve operative**, të cilat ishin parashikuar për këtë periudhë, por janë shtyrë për në tremujorët në vijim;
- **Shpenzimet operative për programe të tjera**, të cilat lidhen ngushtësisht me zbatimin e projekteve specifike, planifikuar për gjysmën e dytë të vitit.

2. Shpenzimet kapitale

Gjatë kësaj periudhe, **nuk janë realizuar shpenzime kapitale**, pasi implementimi i projekteve të investimit është planifikuar të nisë në muajt pasardhës të vitit.

Fondi i investimeve për vitin 2025 është orientuar kryesisht drejt:

- **Investimeve në infrastrukturën e turizmit**, në bashkëpunim me bashkitë e qarkut;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLOR

- **Projekteve studimore dhe të projektimit**, që do të zhvillohen në partneritet me njësitë e qeverisjes vendore.

3. Projektet me financim të huaj

Të gjitha projektet me financim të huaj të trashëguara nga vitet e mëparshme janë mbyllur brenda vitit 2024.


Megjithatë, për vitin 2025, në buxhet është parashikuar një **fond rezervë**, i cili do të shërbejë si **garanci për parafinancimet dhe bashkëfinancimet e projekteve të reja me financim të huaj**, në rast se Këshilli i Qarkut Vlorë bëhet pjesë e tyre gjatë vitit.

Nr.	Emertimi sipas programeve	Plan 4 mujor	Fakt 4 mujor	Diferenca	% realizim
1	Administrata-Prog 01110	56,647,605	20,393,336	36,254,269	36
	Paga (600)	8,200,000	6,958,428	1,241,572	85
	Sigurime shoq/shend (601)	2,200,000	1,140,868	1,059,132	52
	Shpenzime operative (602)	5,213,938	2,294,040	2,919,898	44
	Transferta te brendsheme (604)	20,458,500	19,958,500	500,000	98
	Transferta te jashteme (605)	0	0	0	0
	Fond I vecante (609)	500,000	0	500,000	0
	Investime (231)	20,075,168	0	20,075,168	0
2	DAMT-Prog 01160	5,335,000	3,576,429	1,758,571	67
	Paga (600)	4,400,000	3,022,432	1,377,568	69
	Sigurime shoq/shend (601)	775,000	526,997	248,003	68
	Shpenzime operative (602)	160,000	27,000	133,000	17
3	Qendra Psiko Sociale Vatra	17,655,578	6,585,843	11,069,735	37
	TOTAL	79,638,183	40,514,108	39,124,075	51



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLOR

Grafiku i realizimit 4-mujor



Analiza analitike e shpenzimeve për Administratën – 4-mujori i parë 2025

(Programi 01110: Administrimi i Këshillit të Qarkut)

Gjatë periudhës janar–prill 2025, buxheti i miratuar për administratën e Këshillit të Qarkut Vlorë është realizuar në masën 36%, me një vlerë totale shpenzimesh prej 20,393,336 lekë, nga 53,647,605 lekë të planifikuara.

Menaxhimi i buxhetit është kryer në përputhje me programimin e miratuar, duke ruajtur një raport të qëndrueshëm ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve dhe duke respektuar limitin e pagesave të miratuar nga Këshilli i Qarkut. Gjatë kësaj periudhe nuk janë konstatuar devijime financiare apo detyrime të papaguara.

1. Shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore (Artikujt 600 + 601)

Realizimi i shpenzimeve për pagat dhe kontributet shoqërore është kryer në përputhje me strukturën organike të miratuar nga Këshilli i Qarkut.

Administrata aktualisht përbëhet nga 13 punonjës (10 civilë dhe 3 të zgjedhur/emëruar), të cilët paguhen sipas nivelit të pagave të miratuara dhe me financim nga transferta e pakushtëzuar e vitit 2025.

- Fondi i realizuar për këtë periudhë: 3,434,908 lekë
- Fondi i planifikuar për vitin 2025: 10,400,000 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I QARKUT VLOR

- Përqindja e realizimit: 33%

Këshilli i Qarkut ka përmbushur në kohë të gjitha detyrimet ligjore për pagat dhe kontributet shoqërore, pa lënë asnjë detyrim të pushlyer.

2. Shpenzime operative dhe këshilltare (Artikulli 602)

Shpenzimet operative janë kryer në funksion të mbështetjes së aktiviteteve të institucionit, në përputhje me programet e miratuara nga Këshilli i Qarkut. Realizimi i këtyre shpenzimeve ka përfshirë:

- furnizime të nevojshme për funksionimin e administratës;
- mbështetje për aktivitetet zyrtare dhe institucionale të planifikuara.
- **Fondi i realizuar:** 2,294,040 lekë
- **Fondi i planifikuar (vetëm për programin 01110):** 5,213,938 lekë
- **Përqindja e realizimit: 44%**

Disa aktivitete të planifikuara për këtë periudhë, si **mirëmbajtja e zyrave dhe pagesat për kuota anëtarësimi**, nuk janë realizuar dhe janë shtyrë për në periudhat pasuese.

1. Shpenzimet për transfertat e brendshme (Artikulli 604)

Gjatë 4-mujorit të parë të vitit 2025, në këtë artikull janë përfshirë transfertat e planifikuara për:

- **Shoqatat e të Verbërve të Qarkut Vlorë, dhe**
- **Transferta për investime në bashki, konkretisht:**

Këshilli i Qarkut ka **transferuar fondin e parashikuar për një investim të planifikuar në Bashkinë Konispol**, në vlerën **20,458,500 lekë**, në përputhje me vendimet e miratuara dhe marrëveshjet ndërinstitutionale.

Ky ndryshim përfaqëson një praktikë të re, ku për investime të natyrës lokale preferohet transferimi i fondit për realizimin nga njësiat përkatëse.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLOR

2. Shpenzimet kapitale (Investime) – Artikujt 230–231

Për periudhën në fjalë, **nuk është realizuar asnjë shpenzim kapital**, si rezultat i:

- Udhëzimeve të marra nga **Ministria e Financave dhe Ekonomisë**;
- Situatës së veçantë zgjedhore dhe **rekomandimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)** për pezullimin e prokurimeve gjatë kësaj periudhe.

Investimet e parashikuara në buxhetin e vitit 2025 do të zbatohen në muajt pasardhës të vitit, në përputhje me kalendarin e miratuar dhe rifillimin e procedurave.

3. Shpenzimet për funksionet e deleguara – DAMT

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark (DAMT) operon si funksion i deleguar nga niveli qendror dhe financohet përmes **transfertës së kushtëzuar** të dhënë nga buxheti i shtetit.

3.1 Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore (Artikujt 600–601)

- Numri aktual i punonjësve: 5 nga 7 pozicione të planifikuara
- Pozicione vakante: 2
- Realizimi i fondit për paga dhe sigurime: **5,175,000 lekë**
- Fondi i planifikuar: **3,549,429 lekë**
- Përqindja e realizimit: **60%**

Shpenzimi është më i ulët se plani vjetor për shkak të **mungesës së dy punonjësve** dhe mosaktivizimit të fondit të veçantë për to.

3.2 Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes (Artikulli 602)

- Fondi i planifikuar: **160,000 lekë**
- Realizimi aktual: **27,000 lekë**

Shpenzimet e kryera lidhen vetëm me **kostot e energjisë elektrike dhe dietave**, ndërkohë që pjesa tjetër e shpenzimeve do të realizohet në periudhat në vijim, në varësi të ecurisë së aktivitetit të drejtorisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLOR

4. Shpenzimet për funksionin e deleguar – Qendra Psiko-Sociale “Vatra”

Gjatë kësaj periudhe, janë realizuar shpenzimet për pagat, sigurimet dhe ushqimin për punonjësit e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”, në kuadër të transfertës së kushtëzuar të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

- Shpenzimet e realizuara: 6,585,843 lekë
- Fondi i planifikuar vjetor: 17,655,578 lekë
- Përqindja e realizimit: 35.3%

Përdorimi i fondeve është kryer në përputhje me destinacionin dhe strukturën e miratuar, në respektim të kërkesave të programit dhe nevojave të qendrës.

Drejtör

Anisa HYSENI

KRYETARI

Ervis Moçka